



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2023:214268
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05851073

K.Dh.Sh.II.nr.866/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me NUI: 810547911, me seli në rr. “Vëllezërit Dragaj”, p.n. në Mitrovicë, kundër debitorit “F.V. B.I - D.P.T. “Mishtore Bunari”, me NUI:811381566, me seli në Mitrovicë, rruga “Brigada 142, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar të kreditorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr. 1637/23 të datës 06.12.2023, me datën 24.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me seli në rr. Vëllezërit Dragaj”, p.n. në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr 1637/23 të datës 06.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr 1637/23 të datës 06.12.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “F.V. B.I - D.P.T. “Mishtore Bunari”, me seli në rr. “Brigada 142”, në Mitrovicë, ashtu që ,Anullohet Urdhri

Përmbartimor P.nr. 1167/23, i lejuar më datë 12.09.2023, nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, dhe Përfundohet ne tërësi përmbartimi në ket çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori ushtruar, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj këtë ankesë dhe ta refuzoj prapësimin e debitorit.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë,

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, P.nr.1167/23 të datës 12.09.2023, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. MI.3.B.44.900384 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t'ia paguajë kreditorit shumën prej 820.15 €, me kamatëvonesë prej 8%, duke llogaritur nga data e paraqitjes së propozimit e deri te pagesa definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, dhe të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësimin brenda afatit ligjor, duke kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se debitorit asnjëherë nuk i është dorëzuar

fatura në origjinal apo kopja fizike e cila do të përcaktonte obligimin e të njëjtit në raport me kreditorin, po ashtu debitorit asnjëherë nuk i është bërë asnjë vërejtje apo kërkesë për pagimin e faturave. Tutje ka theksuar se kërkesa për përmbushjen e obligimit është më e vjetër se 1 (një) vjeçare, ashtu që në përputhje me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD) kjo kërkesë është parashkruar. I ka propozuar gjykatës që aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit si i bazuar si dhe të prishet urdhri për përmbarim Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se procedura përmbarimore në këtë rast ka filluar dhe është zbatuar sipas faturave apo ekstraktet e kreditorit, të cilat i përmbajnë të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin duke u bazuar dhe mbështetur në nenin 40 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pabazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi duke u aprovuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi, me arsyetim se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr. MI.3.B.44.900384, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së. Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” Andaj në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbarim është lejuar sipas një dokumenti – nga librat afarist në kuadër të Ndërmarrjes KRM “Uniteti” SH.A, gjykata gjeti se Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr. MI.3.B.44.900384, mbi të cilin mbështetet propozimi për

përmbardim, e mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbardja e borxhit nga debitori.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale dhoma e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate shihet qartë se në dokumentin për përmbardim nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbardja e borxhit nga debitori dhe se borxhet të cilat janë akumuluar në fund të secilit nga vitet: 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë bartur në vitin pasues, me përshkrimin “carried over from the duke e faturuar të njëjtin si borxh të ri dhe si rrjedhojë nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por të njëjtat i refuzoj si të pabazuara ngase nuk kishin me ndikim ndryshe në këtë çështje përmbardimore, andaj ankesën e kreditorit e refuzoj si të pabazuar dhe aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Kështu gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj

gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë i bazuar.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II nr.866/24, me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2023:214268
Datë: 24.06.2024
Numri i dokumentit: 05851073